

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim
(zgjidhjet)**

P6

Data 12/10/2019

Detyra 1

Jeni të punësuar si senior i auditimit në firmën Audit-A. Aktualisht jeni duke planifikuar auditimin e kompanisë Ambëlsina Shpk, klient i juaji që është i specializuar në prodhimin e tortave për martesë. Viti fiskal i Ambëlsina është 31 dhjetor 2018. Gjatë punës paraprake të auditimit, ju keni vërejtur se profitabiliteti i kompanisë ka rënë dhe kostot janë duke u rritur, për derisa çmimet e shitjes janë më të larta se të konkurrencës për shkak të prodhimit të ulët. Kompania në vitet e fundit është mbështetur në mbiterheqje bankare për të financuar aktivitetet e saj. Ky shqetësim ishte ngritur edhe nga menaxhmenti në takimin që kishin pasur me ty. Gjatë takimit, diskutimi u fokusua në aktivitetet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar likuiditetin e kompanisë. Menaxhmenti ju informoi se janë duke planifikuar të zgjerojnë linjat e prodhimit për torta, pasi që linja ekzistuese e mban pjesën e saj të tregut. Kompania kishte kërkuar kredi nga banka për të financuar zgjerimin si dhe për të mbajtur kapitalin qarkullues në nivelin aktual. Për të mbështetur këtë kërkesë për kredi, kompania ka përgatitur një parashikim të rrjedhës së parashë për dy vite nga data e përfundimit të periudhës së raportimit. Departamenti i auditimit të brendshëm kishte raportuar këtë parashikim tek bordi i drejtorëve. Mirëpo, banka kishte kërkuar nga kompania një raport nga auditorët e jashtëm për të konfirmuar arsyeshmërinë e këtij parashikimi. Pas kësaj kërkesë, kompania ka kërkuar nga ju të ekzaminoni rrjedhën e parashë dhe ti raportoj bankës.

Kërkohet:

- (a) Përshkurani nivelin e sigurisë që duhet të përfshihet për raportin për bankën. **(5 pikë)**
- (b) Vlerësoni procedurat që duhet të kryhen për të ekzaminuar parashikimin e rrjedhës së parashë. **(9 pikë)**
- (c) Përshkruani kërkesat e mëposhtme lidhur me SNA 300 – Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare:
- (i) Përfitimet kryesore të një planifikimit të duhur në kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare **(6 pikë)**
- (ii) Faktorët kryesor që duhet të konsiderohen kur përpilohet strategjia e përgjithshme e auditimit. **(5 pikë)**

[Total 25 pikë]

Zgjidhja

(a) Niveli i sigurisë

Banka duhet të informohet që lloji i raportit që ju mund ta jepni është raport me siguri të kufizuar. Zakonisht këto angazhime kryhen përmes angazhimeve për rishikime të informatave financiare. Në këtë raport ju si auditor do të tregoni se asgjë nuk ju ka tërhequr vëmendjen për të besuar se supozimet në përpilimin e rrjedhës së parashë nuk ofrojnë bazë të arsyeshme për parashikimin e parashë. Raporti më tutje do të vazhdonte të tregon se parashikimi i parashë është përgatitur si duhet bazuar në ato supozime. Për shkak se parashikimi i parashë është vlerësim i rrjedhës së parashë në të ardhmen i cila është e pasigurt, nuk ka mundësi formë tjetër të raportimit përveç sigurisë së kufizuar.

(b)

- Rillogarit parashikimin e parashë për të verifikuar saktësinë matematikore.
- Rishiko parashikimet e kaluara me rezultatet aktuale për të përcaktuar nëse parashikimet e kaluara ishin të sakta. Nëse parashikimet ishin të arsyeshme në të kaluarën, ka gjasë që edhe parashikimet aktuale të jenë të besueshme.
- Konfirmo supozimet e përdorura në parashikimin e parashë. Psh ju jeni në dijeni se kostot janë duke u rritur.

- Rishiko buxhetet e detajuara nga Departamenti i shitjes për dy vitet në të ardhmen dhe diskuto cilat dyqane janë duke i targetuar. Kjo do të ju ndihmoj të përcaktoni nëse të hyrat janë të bazuara në shitje të parashikuara.
- Rishiko vlerësimin e kërkesave për pasuri joqarkulluese nga Departamenti i prodhimit të nevojshme për të linjën e re të prodhimit. Vlerësoni koston e përafërt të pasurive të nevojshme.
- Përputhni saldon fillestare të parasë në parashikim me saldon përfundimtare të parasë në libra, për saktësi.
- Konsidero mjaftueshmërinë e kapitalit qarkullues që do të nevojitet për zgjerimin e vijave të prodhimit. Rritja në kapitalin qarkullues do të rezultoj me dalje të parasë.
- Nëse është relevante rishiko periudhën pas fundit të vitit për të krahasuar me performancën aktuale kundrejt shifrave të parashikuara.
- Rishiko procesverbalet e takimeve të bordit për çfardo çështje që janë relevante për parashikimin e parasë.

(c)

(i) Përparësitë kryesore të planifikimit të auditimit:

- Ndihmojnë auditorin të i kushtoj vëmendje të duhur fushave të rëndësishme të auditimit
- Ndihmojnë auditorin të identifikoj dhe zgjidhë problemet me kohë.
- Ndihmojnë auditorin të organizojë dhe menaxhojë angazhimin e auditimit me qëllim që të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase.
- Ndihmoj në përzgjedhjen e anëtarëve të ekipit të angazhimit me nivel të duhur të aftësive dhe njohurive për tu përgjigjur ndaj rreziqve të pritura, dhe të përcaktoj punën e duhur për secilin anëtar.
- Ndihmon në udhëheqjen dhe mbikqyrjen e ekipit të auditimit dhe rishikimin e punës së tyre.
- Ndihmoj, kur është e zbatueshme, koordinimin e punës me auditorët e komponentit dhe me ekspertët.

(ii) Përcaktimi i strategjisë së auditimit:

- Identifikimi i karakteristikave të angazhimit që definojnë objektin e auditimit;
- Vërtetojnë objektivat e raportimit nga angazhimit për të planifikuar kohën e auditimit dhe natyrën e komunikimeve të kërkuara;
- Konsiderojnë faktorët, që sipas gjykimit profesional të auditorit, janë domethënëse për udhëheqjen e ekipit të auditimit;
- Konsiderojnë rezultatet e aktiviteteve paraprake të angazhimit dhe nëse është e zbatueshme, njohuria e përftuar nga angazhimet tjera është relevante; dhe
- Vërtetojnë natyrën, kohën dhe shtrirjen e burimeve për të kryer angazhimin.

Detyra 2

(a) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Heddi & Partnerët. Para disa ditësh njëri nga stafi i ri i auditimit, gati nuk shpalosi disa informata konfidenciale të njërit nga klientët e firmës. Ky kërcanim ishte identifikuar me kohë dhe ishte parandaluar shpalosja e këtyre informatave.

Kërkohet:

Përshtkruani rastet kur një auditor mund të shpalos informatat konfidenciale për një klient të tij/saj/. **(8 pikë)**

(b) Seniori i auditimit që është ngarkuar me auditimin e pagave të klientit të auditimit JohanS, ju ka ofruar informatat në vijim:

Punonjësit e JohanS paguhen mbi bazën e orëve të punuara dhe të sasive të prodhuara. Orët e punuara regjistrohen në kartela kohore ndërsa sasitë e prodhuara konfirmohen nga mbikqyrësi i prodhimit. Për shkak të luhatjes së vëllimit të punës, JohanS ende paguan të punësuarit me para në dorë në fund të çdo jave për javën e kaluar. Punësimi i të punësuarve të rinj aprovohet nga drejtori menaxhues. Departamenti i burimeve njerëzore mban regjistrat e punonjësve dhe normat e pagesave. Arkëtari është i ndarë nga departamenti i pagave. Auditimet e mëparshme kanë identifikuar disa mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm të pagave. Sipas kësaj mangësie, punonjësi në departamentin e pagave ishte në gjendje të kryente mashtrim duke krijuar punonjës fiktiv në listën e pagave dhe kështu duke keqpërdorur pagat. Disa nga testet tuaja të auditimit janë dizajnuar të zbulojnë nëse ky mashtrim është ende duke ndodhur. Po ashtu gjatë secilit auditim testohen edhe punësimet e reja dhe largimet nga puna për tu siguruar se punonjësit nuk paguhen para fillimit të punës ose pas largimit nga puna.

Kërkohet:

(i) Përshtkruni kontrollet kryesore që duhet të ekzistojnë në sistemin e pagave dhe shpjegoni qëllimin e tyre. **(6 pikë)**

(ii) Duke supozuar se keni vendosur të mos merrni pjesë në ditën kur shpërndahen pagat me para, rekomandoni teknikat që duhet të përdoren për të verifikuar ekzistencën e të punësuarve. **(5 pikë)**

(iii) Tregoni si duhet të testohen punësimet e reja dhe largimet nga puna. **(6 pikë)**

[Total 25 Pikë]

Zgjidhja

(a) Në vijim janë rrethanat kur anëtarë mund të kërkohet të shpalosin informatat konfidenciale të klientëve të angazhimit:

1. Shpalosja është e lejuar me ligj dhe është autorizuar nga klienti ose punëdhënësi;
2. Shpalosja kërkohet me ligj, psh:
 - i. Për qëllime gjyqësore si dëshmi, etj, ose
 - ii. Shpalosje ndaj autoriteteve publike lidhur me ndonjë shkelje që duhet të raportohet
3. Ekziston një detyrim profesional ose e drejtë për të shpalosur informata, kur nuk ndalohet me ligj:
 - i. Për pajtueshmëri me rishikimet për kontroll të cilësisë nga organizatat profesionale ose organet rregullatore;
 - ii. Për tu përgjigjur ndaj hetimeve nga organizatat profesionale ose organet rregullatore
 - iii. Për të mbrojtur interesin profesional të anëtarëve në ndonjë çështje gjyqësore; ose
 - iv. Për pajtueshmëri me standardet teknike dhe kërkesat etike.

(b) (i) Kontrollët kryesore në sistemin e pagave dhe qëllimi i tyre:

- Duhet të ketë ndarje të duhur të detyrave në sistemin e pagave – personi që llogarit pagat nuk duhet të paguaj ato.
- Ka kontroll të duhur mbi ruajtjen e parasë për pagat dhe pagat e papaguara.
- Pagat paguhen vetëm për punëtorët që kanë kryer punën, jo në avans.
- Punëtorët paguhen sipas normës së autorizuar nga menaxhmenti.
- Ka autorizim të duhur për personat që punësohen dhe largohen.
- Zbritjet për tatime, pensione etj llogariten dhe paguhen si duhet.
- Pagesat ju bëhen punëtorëve që janë regjistruar në kompani.
- Transaksionet e pagave regjistrohen saktë në librat e kompanisë përfshirë shpërndarjen e tyre në mes administratës, prodhimit, shitjes, etj.

Qëllimi i këtyre kontrolleve është të sigurohet kompania se punëtorët paguhen sipas normave të autorizuar për punën e kryer dhe se transaksionet janë regjistruar saktë në librat e kompanisë si dhe pagesat për çfardo zbritje dhe ndalese janë bërë.

(ii) Teknikat për të kontrolluar ekzistencën e kompanisë

- Kontrollimi i nënshkrimit të të punësuarit kundrejt nënshkrimeve në kontratë në departamentin e personelit.
- Kontrollimi i numrit personal në dokumentet e identifikimit.
- Përftimi i listave të të punësuarve sipas departamentve dhe kontrollimi i emrave.
- Kontrollimi i transfereve nga banka dhe krahasimi i llogarisë me emrat nga kontrata.

(iii) Testet për të punësuarit e rinj dhe largimet nga puna

Qëllimi i këtij testi është që të sigurohemi se punonjësit nuk paguhen para fillimit të punës por as pasi që janë larguar nga puna.

Përzgjedhja e dy listave të pagave, psh tre muaj nga njëra tjetra dhe krahasimi i emrave në të dy listat. Kur emrat paraqiten në të dy listat, do të thotë se punonjësit janë paguar për 3 muaj. Kur emrat paraqiten në listën e parë dhe jo në të dytën, këta janë personat e larguar dhe kur personi paraqitet në listën e dytë dhe jo të parën, ky është person që ka filluar punën në këtë muaj.

Pastaj datat e fillimit dhe përfundimit duhet të verifikohen duke kontrolluar regjistrat e departamentit të burimeve njerëzore për tu siguruar se janë paguar si duhet përgjatë periudhave të caktuara.

Teknikë tjetër është përftimi i listave nga Departamenti i burimeve njerëzore dhe pas krahasimit të dative të punësimit dhe largimit, testimi i muajve përkatës, nëse është bërë pagesa e duhur.

Detyra 3

(a) K-Mobile është një kompani e madhe e telefonisë mobile e cila operon me një rrjet të dyqaneve në tërë Evropën. Viti fiskal i kompanisë është 31 dhjetor 2018. Ju jeni seniori i auditimit nga firma Pipi Audit. K-Mobile është klient i ri i firmës tuaj dhe tani jeni duke planifikuar auditimin së bashku me menaxherin e auditimit. Ju kanë ofruar informatat në vijim: K-Mobile blen mallrat nga një furnitor në Azinë Jugore dhe këto mallra dërgohen në depon qendrore të kompanisë. Mallrat zakonisht janë në transit për dy javë dhe kompania i regjistron si duhet ato në momentin e pranimit. K-Mobile nuk bën numërim fizik të stoqeve në fund të vitit por numërim mujor përmes sistemit e tyre të vazhdueshëm të stoqeve. Çfardo gabimi i identifikuar korrigjohet në sistem në atë muaj. Gjatë vitit kompania filloi me pagesën e bonuseve për personelin e tyre të shitjes që bazohen në shitje. Caku i bonuseve ishte bazuar në rritjen e numrit të konsumatorëve që nënshkruajnë kontrata 24 muajshe për telefoni. Ky sistem i bonuseve u tregua i suksesshëm dhe kompania kishte një rritje prej 15% sidomos në muajt e fundit të vitit. Niveli i llogarive të arkëtueshme ishte konsiderueshëm më i lart se viti i kaluar dhe kishte shqetësime për aftësinë e pagesë për disa nga konsumatorët. K-Mobile kishte një politikë të rivlerësimit të tokës dhe ndërtesave dhe këtë vit kishin azhurnuar vlerësimin për të gjitha tokat dhe ndërtesat. Gjatë vitit drejtorëve u ishin paguar bonuse domethënëse dhe këto ishin përfshirë së bashku me paga. Legjislacioni vendor kërkon shpalosje të veçantë për bonuset.

Kërkohet:

- (i) Përshkruani PESË rreziqe të auditimit dhe shpjegoni përgjigjet e auditorit ndaj këtyre rreziqeve të përshkruara në planifikimin e auditimit të K-mobile. **(10 pikë)**
- (ii) Shpjegoni procedurat e auditimit që duhet të kryhen për ti mbështetur në sistemin e vazhdueshëm të numërimit të stoqeve për stoqet e fundvitit. **(3 pikë)**
- (iii) Përshkruani procedurat thelbësore të cilat duhet të kryhen për të konfirmuar pagesat e bonuseve ndaj drejtorëve që janë përfshirë në pasqyrat financiare. **(2 pikë)**

(b) Ju jeni senior i auditimit në firmën CC Audit. Klineti juaj, kompania Bebe ShA është e listuar dhe është klient për tetë vite. Bebe është e specializuar në prodhimin e instrumenteve muzikore. Teuta, partnere e angazhimit tashmë ka përfunduar shtatë vite të auditimit me Bebe dhe sipas politikave të firmës së auditimit, ajo do të ndrrohet (rrotacion). Partneri i ri i angazhimit, Arianiti, ka sugjeruar që Teuta të bëhet rishikues i pavarur i angazhimit për auditim, në mënyrë që të ruhet marrëdhënia e mirë me klientin (Bebe). Përveç kësaj, kompania Bebe ka kërkuar që Teuta të marrë pjesë në takimet e komitetit të auditimit pasi që njëri nga drejtorët joekzekutiv ishte larguar nga kompani. Kompania po ashtu kërkoi nga Arianiti dhe partneri tjetër i CC Audit të ju ndihmonte në rekrutimin e drejtorit të ri joekzekutiv. Tarifa totale e auditimit nga Bebe e vitit të kaluar ishte e barabart me 16% e të hyrave totale të firmës së auditimit. Tarifa e vitit aktual nuk është konfirmuar ende, mirëpo së bashku me tarifat e shërbimeve të tatimeve dhe shërbimeve tjera joaudituese mund të jetë më e lart se ajo e vitit të kaluar. Tarifa e auditimit të vitit të kaluar është duke u paguar më këste mujore nga Bebe, mirëpo nuk është bërë asnjë pagesë në tre muajt e fundit. Menaxheri i auditimit për Bebe sapo ka informuar firmën e auditimit se do të largohet nga firma për tu punësuar ishef i kontabilitetit për kompaninë Bebe.

Kërkohet:

- (i) Identifikoni dhe shpjegoni PESË kërcënime etike të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë e firmës CC Audit gjatë auditimit të Bebe; dhe
- (ii) Për secilin kërcënim shpjegoni si mund të zvogëlohet në një nivel të pranueshëm. **(10 pikë)**

[Total 25 Pikë]

Zgjidhjet

(a) Rreziqet e auditimit dhe përgjigjet

Rreziku i auditimit

Kompania është klient i ri i firmës së auditimit. Pasi që ekipi nuk është i njohur me politikat e kontabilitetit, transaksionet dhe saldot, do të ketë rrezik të shtuar të moszbulimit.

Kompania blen mallrat nga Azia jugore dhe mallrat qëndrojnë në transit për 2 javë. Ka rrezik që në fund të vitit prerja e stokeve të mos jetë e saktë, përfshirë blerjet dhe llogaritë e pagueshme. Pasi që kompania regjistron si duhet mallrat, vetëm kur pranohen, atëherë në fund të vitit vetëm mallrat që janë në depo duhet të jenë të përfshira në lista.

Kompania përdor numërim mujor të stokeve përmes sistemi të vazhdueshëm të stokeve. Sipas këtij sistemi, kompania duhet që së paku një herë në vit të numërojë fizikisht stoqet për të korrigjuar çfardo ndryshimi në sasi.

Këtë vit kompania ka filluar me pagesën e bonuseve në shitje; kjo mund të çojë në problem me prerjen për shkak se punonjësit mund të kenë qëllim maksimizimin e bonuseve të tyre. Të arkëtueshmet janë më të larta se viti i kaluar dhe ka shqetësime për aftësinë paguese të disa prej konsumatorëve. Ka rrezik të mbivlerësimit të të arkëtueshmeve.

Të arkëtueshmet po ashtu mund të jenë të mbivlerësuara për shkak të skemës së bonuseve; mund të ketë rrezik që disa nga konsumatorët mund të jenë fiktiv.

Kompania ka politikë rivlerësimit të tokave dhe ndërtesave dhe ato janë rivlerësuar edhe këtë vit.

Prona, impiantet dhe pajisjet mund të jenë të mbi ose nënvlerësuara nëse nuk janë bërë sipas SNK 16. Gjithashtu rivlerësimet duhet të jenë të shpalosura si duhet në Pasqyrat financiare. Drejtorët janë paguar me bonuse domethënëse dhe legjislacioni kërkon që ato të shpalosen veçantë.

Përgjigja nga auditori

Auditori duhet të ketë një ekip me përvojë të duhur. Po ashtu duhet të alokohen kohë e duhur për anëtarët e ekipit për të përfutur njohuri mbi kompaninë dhe rreziqe anormale materiale.

Auditori duhet të testojë prerjen duke testuar disa fletëdërgesa para dhe pas fundit të vitit për të siguruar se janë regjistruar në periudhën e duhur.

Duhet të testohet plotësia e numërimeve të kryera.

Duhet të testohet prerja e të hyrave, duke u fokusuar në anulimet e kontratave të shitjes menjëherë pas fundit të vitit.

Duhet të testohen arkëtimet pas fundit të vitit dhe të rishikohet lista e llogarive të vjetra për të vlerësuar pohimin e vlerësimit. Gjithashtu duhet të konsiderohet mjaftueshmëria e lejimeve për LLA.

Përdorimi i konfirmimeve të LLA për të konfirmuar ekzistencën e konsumatorëve dhe LLA përkatëse.

Diskutoni me menaxhmentin për procesin e ndjekur në rivlerësim dhe nëse janë rivlerësuar të gjitha pasuritë e klasës si dhe nëse vlerësimi është kryer nga ndonjë ekspert. Rishikimi i shpalosjeve të PF

Diskutoni çështjen me menaxhmentin dhe rishikoni shpalosjet e PF.

(ii) Procedurat e auditimit për sistemin e vazhdueshëm të stoqeve:

- Ekipi i auditimit duhet që së paku një herë të marrë pjesë në numërimin mujor të stoqeve për të rishikuar kontrollet e brendshme për numërim të stoqeve.
- Ekipi i auditimit duhet të konfirmoj se të gjitha stoqet janë numëruar ose dot ë numërohen së paku një herë në vit duke i rishikuar listat e numërimit nga kompania.
- Rishikimi i korigjimeve që janë bërë në regjistrat e stoqeve në baza mujore dhe përfitimi i njohurisë mbi nivelin e ndryshimeve mujore.
- Nëse ka ndryshime domethënëse gjatë gjithë kohës, kjo mund të jetë tregues se regjistrat e stoqeve nuk mbahen si duhet. Diskutoni me memaxhmentin se si sigurohen se stoqet në fundvit nuk mbi ose nënvlerësohen.
- Konsideroni pjesëmarrjen në numërimin e stoqeve në fund të vitit dhe të ndërmerrni numërim testues nga listat në depo dhe nga depo në lista për të konfirmuar ekzistencën dhe plotësinë.

(iii) Procedurat thelbësore për bonuset dhe kompenzimet e drejtorëve

- Merrni një listë të kompenzimit të drejtorëve përfshirë bonuset e paguara dhe rillogaritni veprimet matematikore.
- Përputhni pagesat individuale të bonuseve me të dhënat nga lista e pagave.
- Konfirmoni shumat e secilit bonus të paguar duke i përputhur me raportet nga banka.
- Rishikoni procesverbalet e takimeve të bordit për të konfirmuar nëse bonuset janë aprovuar.
- Përfitoni përfaqësimet e shkruara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë e pagesave të bonuseve ndaj drejtorëve.
- Rishikoni shpalosjet e bëra për bonuset dhe vlerësoni nëse janë në pajtueshmëri me legjislacionin vendor.

(b) Kërcënimet etike

(i) Kërcënimi etik

Teuta ishte auditore e angazhimit për kompaninë për shtatë vitet e fundit dhe kohë më parë është zëvendësuar.

Është propozuar që tash e tutje ajo të kryente rolin e rishikuesit të pavarur. Kjo përfaqëson kërcënim të njohjes pasi që partnerja një periudhë të gjatë ka kryer auditimin e kompanisë dhe mund të cenohet skepticizmi profesional dhe objektiviteti.

Kompania ka kërkuar që Teuta, ish partnerja e angazhimit të marrë pjesë në takimet e komitetit të auditimit pasi që drejtori joekzekutiv është larguar.

Ky rast paraqet kërcënim ndaj interesit personal pasi që firma e auditimit mund të perceptohet se është duke kryer rol menaxherial në kompani, prandaj kërkënon objektivitetin

Nga firma e auditimit është kërkuar të asistojë kompaninë në rekrutimin e drejtorit joekzekutiv.

Ky përfaqëson kërcënim të interesit personal, pasi që firma nuk mund të rekrutojë staf menaxherial dhe senior të klientit, sidomos të drejtorëve joekzekutiv të komitetit të

(ii) Menaxhimi i kërcënimeve

Pasi që kompani është e listuar, atëherë Teuta nuk mund të caktohet si rishikuese e angazhimit për një periudhë së paku 2 vjeçare. Duhet të caktohet një partner tjetër.

Firma duhet me mirësjellje të refuzojë kërkesën pasi që përfaqëson kërcënim të madh.

Firma e auditimit ndoshta mund të ju ndihmojë duke rishikuar listën e të përzgjedhureve të ngushtë, mirëpo gjithsesi duhet të sigurohen se nuk ndikojnë në vendimet e bordit.

auditimit pasi që ata drejtëpërdrejt kanë përgjegjësi të caktojnë auditorin e jashtëm. Tarifa totale e pranuar nga kompania vitin e kaluar ishte 16% e të hyrave totale të firmës së auditimit. Tarifa e këtij viti ende nuk dihet por mund të jetë e barabart ose më e lart se 16%.

Ka një kërcënim të mundshëm të interesit personal në këtë rast.

Tarifa e auditimit të vitit të kaluar është duke u paguar në baza mujore, mirëpo në tre muajt e fundit nuk është bërë ndonjë pagesë.

Ky rast mund të rrit kërcënimin e interesit personal për shkak se firma e auditimit mund të ketë presion për të pranuar korrigjime në pasqyra financiare në mënyrë që tarifa të paguhet nga klienti.

Përveç kësaj çfardo tarife e papaguar mund të konsiderohet si hua e dhënë për klientin.

Huatë për klientin nga auditori janë të ndaluara me kodin e etikës.

Menaxheri i auditimit i ngarkuar me auditimin e kompanisë është duke u larguar nga puna për tu punësuar te klienti. Ky rast përfaqëson kërcënim të interesit personal dhe të njohjes për shkak se menaxheri i auditimit është i njohur me planin e auditimit.

Firma e auditimit duhet të vlerësoj nëse tarifat e kombinuara ndaj një klienti përfaqësojnë më shumë se 15%, nëse kjo është e vërtetë atëherë së pari duhet të shpaloset te bordi i drejtorëve ose të hiqet dorë nga ndonjë shërbim joauditues apo auditues.

Firma e auditimit duhet të diskutoj me personat e ngarkuar me qeverisjen për arseyt e mospagesës në tre muajt e fundit. Ata duhet të pajtohen që tarifa e vitit të kaluar të paguhet para se një pjesë domethënëse e auditimit të kryhet.

Duhet të caktohet një menaxher i ri i angazhimit dhe puna që është kryer duhet të rishikohet në mënyrë të pavarur.

Këshillohet që plani i auditimit të modifikohet për të shmangur njohjen e qasjes së auditimit nga menaxheri i mëparshëm.

Detyra 4

(a) Druari Shpk prodhon mobile sipas porosisë dhe viti fiskal përfundon me 31 dhjetor. Kompania blen lëndën e parë nga një numër i furnitorëve. Më poshtë është përshkrimi i sistemi të blerjeve të kompanisë Druari.

Kur mbikqyrësit e prodhimit kërkojnë lëndë të parë, ata e plotësojnë kërkesën për blerje e cila dorëzohet në departamentin e porosisë së blerjeve. Format e kërkesës për blerjes nuk kërkojnë autorizim dhe nuk bëhet ndonjë referencë për gjendjen aktuale të stoqeve të lëndës së parë e cila kërkohej të blihet.

Personeli i departamentit të porosive të blerjeve përdorin format e kërkesës për të krijuar porositë e blerjeve që kanë numra të njëpasnjëshëm për të porositur mallrat nga furnitorët e aprovuar në listë. Lista e furnitorëve herën e fundit ishte azhurnuar para 24 muajsh. Drejtori i blerjeve autorizon porositë para se ato të dërgohen tek furnitorët. Kur mallrat pranohen, personeli i depos i verifikon ato me fletëdërgesën e furnitorit dhe kontrollon nëse cilësia e mallrave të pranuar është e kënaqshme. Ata plotësojnë fletë pranimin e mallit në formën standarde që është e paranumruar dhe me numra të njëpasnjëshëm dhe e dërgon një kopje të saj në departamentin e financave. Faturat e furnitorëve dërgohen direkt te zyrtari që mban librin e blerjeve i cili i ruan ato manualisht deri në fund të javës. Në fund të javës ai i fut ato fatura në librin e blerjeve dhe ia përcakton secilës faturë nga një numër unik bazuar në kodin e furnitorit. Faturat rishikohen dhe autorizohen për pagesë nga drejtori financiar, por pagesa bëhet vetëm pas 60 ditësh pasi që fatura është futur në sistem.

Kërkohet:

Sa i përket sistemit të blerjeve të kompanisë:

(i) Identifiko dhe shpjego PESË mangësi; dhe

(ii) Rekomando nga një kontroll që duhet të vendoset nga kompania për secilën mangësi.

(10 pikë)

(b) (i) Identifikoni dhe shpjegoni DY pohime të pasqyrave financiare që lidhen me klasët e transaksioneve; dhe

(ii) Për secilin pohim të identifikuar, përshkruani nga një procedurë thelbësore që lidhet me auditimin e TË HYRAVE. **(5 pikë)**

(c) Hotel Puhia (Hoteli) operon me një zingjir të klubeve të fitnesit. Fundi i vitit fiskal është 31 dhjetor 2018.

Ju jeni menaxher i auditimit dhe auditimi përfundimtar do të fillojë së shpejti. Ju duhet të shqyrtoni çështjen në vijim:

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe akrualet

Drejtori financiar i hotelit ju ka lajmëruar se ka ndodhur një gabim në librin e blerjes në fund të vitit. Në vend që libri të mbyllet me 31 dhjetor, aksidentalisht është mbyllur me 25 dhjetor. Të gjitha faturat e blerjeve në mes të datës 25 dhjetor dhe fundit të vitit janë postuar në librin e blerjeve të vitit të ardhshëm 2019.

Kërkohet

Përshkruani procedurat e pavarura (thelbësore) që do ti kryenit për të përfutur evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për dy çështjet e mësipërme. **(10 pikë)**

[Total 25 Pikë]

Zgjidhjet

(a) Mangësitë dhe kontrollet

Mangësitë (i)

Format e kërkesës për blerje plotësohen nga mbikqyrësit e prodhimit por nuk autorizohen. Kjo rrit rrezikun e blerjeve mashtruese ose përositjen e mallrave që nuk janë të nevojshme, duke çuar në dalje të panevojshme të parasë.

Porositë bëhen pa u kontrolluar nivelet e mallrave në depo. Kjo mund të rezultoj me porosi për mallrat që kompania nuk ka nevojë.

Pasi që kompania nuk kontrollon nivelet e materialeve mund të shkakto mungesë të stoqeve dhe pamundësi për të përfunduar porositë e konsumatorëve.

Departamenti i porosive mban një listë të furnitorëve të aprovuar; mirëpo lista nuk është azhurnuar në 24 muajt e fundit.

Pasi që kjo listë nuk është azhurnuar, furnitorët nga të cilët kompania blen, mund të mos jenë më të lirët ose me cilësinë e kërkuar. Kjo mund të rezultoj që kompania të blej materiale më të shtrenjta ose me cilësi të dobët.

Mallrat pranohen pa u kontrolluar urdhërblertjet. Kjo mund të rezultoj me pranim të mallrave që nuk janë porositur.

Faturat e blerjeve arkivohen manualisht dhe vetëm njëherë në javë futen në librin e blerjeve. Ka rrezik se atom und të humben. Kjo mund të rezultoj me nënvlerësim të të pagueshmeve.

Faturat e blerjes nuk përputhen me fletëpranimet para autorizimit për pagesë. Kjo mund të rezultoj me pagesa për mallrat që nuk janë pranuar.

(b) Pohimet

Të gjitha transaksionet e shitjes kanë ndodhur dhe kanë të bëjnë me entitetin **(ndodhja)**

Të gjitha transaksionet e shitjes të cilat është dashur të regjistrohen, janë regjistruar **(plotësia)**

Shumat që kanë të bëjnë me transaksionet janë regjistruar në mënyrë të duhur **(saktësia)**

Të gjitha transaksionet janë regjistruar në periudhën e duhur **(prerja)**

Të gjitha transaksionet janë regjistruar si duhet **(klasifikimi)**

Kontrollet (ii)

Format e kërkesave duhet të autorizohen nga menaxheri i prodhimit ose drejtori para se ato të dërgohen në departamentin e porosive. Ky department nuk duhet të procesoj asnjë kërkesë të paautorizuar.

Sistemi i stoqeve duhet të azhurnohet për të regjistruar nivelet minimale/maksimale të materialeve.

Kompania duhet të përcaktoj nivelet minimale të riporosisë.

Lista e furnitorëve të aprovuar duhet të rishikohet dhe të azhurnohet së paku njëherë në vit.

Një kopje e urdhërblertjes duhet të dërgohet në depo që të përdoret për kontroll kur mallrat arrijnë në depo.

Nëpunësi i librit të blerjeve duhet të regjistroj faturat në baza ditore. Nëse kjo nuk është praktike, ai së paku duhet të ja caktoj nga një numër unik të njëpasnjëshëm që të ndjek pastaj mungesën e ndonjë numëri në libër.

Të gjitha faturat e blerjeve duhet të përputhen me fletëpranimet.

(ii)

Testet thelbësore

Për një mostër të transaksioneve të shitjes të regjistruar në libër, **ndjekni** faturat e shitjes deri tek porositë e shitjes dhe fletdërgesat – ndodhja

Gjurmoni një mostër të dokumenteve të dërgesës së mallit deri tek faturat e shitjes dhe tek libri i shitjes dhe të arkëtueshmeve – plotësia

Për një mostër të faturave të shitjes, **krahasoni** çmimet me listën e autorizuar të çmimeve - saktësia

(c) Procedurat thelbësore

Të pagueshmet dhe akrualet

– Llogaritni ditët e llogarive të pagueshme për klubet dhe krahasoni me vitet e mëparshme, hetoni çfardo ndryshimi të rëndësishëm, sidomos nëse ka zvogëlim në këtë vit.

– Krahasoni totalon e LLP dhe listën e akrualeve kundrejt vitit të mëparshëm dhe hetoni ndryshimet e rëndësishme.

– Diskutoni me menaxhmentin procesin që ata kanë ndërmarrë për të kuantifikuar nënvlerësimet e

LLP për shkak të gabimeve me prerjesn dhe konsideoni maerialitetin e gabimeve.

– Diskutoni me menaxhmentin nëse është përfshirë ndonjë korrigjim për atë nënvlerësim.

– Përzgjedhni një mostër të faturave të blerjes të pranuar në mes të periudhës 25 dhjetor dhe fundit të vitit dhe ndjekni ato deri te përfshirja në akruale ose si pjesë e korrigjimeve të LLP.

– Rishikoni pagesat pas datës së raportimit; nëse ato kanë të bëjnë me vitin aktual, pastaj ndjekni deri te libri i blerjeve ose lista e akrualeve për të siguruar sse janë regjistruar në periudhën e duhur.

– Përftoni ekstraktet e furnitorëve dhe harmonizoni ato me saldot nga libri i blerjes dhe hetoni ndonjë

element.

– Përzgjedhni një mostër të saldove të LLP dhe kryeni konfirmimin e LLP, ndiqni çfardo mos-përgjigje nga furnitorët dhe mosbarazim në mes të konfirmimit dhe saldove të LLP.

– Përzgjedhni një mostër të fletpranimeve të mallrave para fundit të vitit dhe pas fundit të vitit dhe

ndiqni nëse janë regjistruar në periudhën e duhur.